



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË TËRHEQIES NGA KANDIDIMIMI PËR KRYETAR TË
BASHKISË LEZHË Z.SALVADOR KAÇAJ, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019.**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 22.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës së tërheqies nga kandidimimi për kryetar të bashkisë Lezhë, z.Salvador Kaçaj për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 21, pika 2, Neni 23, pika 1, gërma a, neni 67, pika 2, 4, 5, dhe 6 neni 72 dhe neni 73, pika 3, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Me vendimin e KQZ-së nr. 230, datë 24.04.2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019 partia "Bindja Demokratike".

Partia, Bindja Demokratike, në përputhje me nenin 5, pika 4, germa "a" të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit, të



Nr. 638 i Vendimit Data 22.05.2019 Ora 17:00 e vendimit

Për shqyrtimin e kërkesës së tërheqies nga kandidimimi për kryetar të bashkisë Lezhë z.Salvador Kaçaj për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

kandidatëve për kryetar bashkie si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i kryetarit të bashkisë.

Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të regjistrojë kandidatët për kryetar apo për këshillin e bashkisë Lezhë, pasi Bashkia Lezhë, administrohet nga më shumë se një KZAZ.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me Vendimin me nr. 598 datë 20.05.2019, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" vendosi:

- Të regjistrojë si kandidat për kryetar në Bashkinë Lezhë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, z.Salvador Kaçaj të propozuar nga Partia "Bindja Demokratike".

Në datë 22.05.2019 në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është protokolluar shkresa me nr.4076/1 prot., e z.Salvador Kaçaj për dorëheqje nga kandidimi për kryetar të bashkisë Lezhë.

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve shqyrtoi dorëheqjen e paraqitur të Z. Salvador Kacaj, bazuar në vendimin nr. 13, datë 28.05.2015 të Kolegjit duke vlerësuar njëkohësisht dhe kufijtë e caktuar nga Kodi Zgjedhor dhe konstaton se:

Kodi Zgjedhor, kandidimin e parashikon si një të drejtë të çdo individi i cili propozohet më pas nga një parti politike apo Koalicion zgjedhor, dhe që duhet të plotësojë disa kriteret Kushtetuese dhe ligjore. Me përfitimin e statusit të kandidatit kjo e fundit nuk është më një e drejtë por një detyrim ligjor për të mundësuar zhvillimin e zgjedhjeve të lira, demokratike dhe pluraliste.

Kodi zgjedhor nuk e parashikon të drejtën e heqjes dorë nga kandidimi, pasi, pas shprehjes së vullnetit të individit se gëzon të drejtën dhe ka vullnet për të kandiduar, dhe regjistrimit si kandidat nga komisioni përkatës, kandidati i nënshtrohet disa procedurave ligjore të parashikuara në Kodin zgjedhor deri në nxjerrjen e rezultatit zgjedhor. Kodi Zgjedhor nuk parashikon shprehimisht në asnjë dispozitë të tij në lidhje me dorëheqjen e kandidatëve.

Gjithashtu, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve vlerëson se pas regjistrimit të kandidatit, procedurat e mësipërme ligjore nuk i nënshtrohen më një vullneti të kandidatit, por janë detyrim ligjor i cili duhet detyrimisht që të zbatohet. Zbatimi i normave ligjore për çdo aspekt të procesit zgjedhor, duke filluar me procesin e kandidimit, votimit, nxjerrjes së rezultateve, garanton në tërësinë e tij një proces të rregullt zgjedhor, në përputhje me standartet ndërkombëtare të gjithëpranuara.

- Kolegji Zgjedhor me vendimin me nr.18 datë 06.05.2015 arsyeton se :



Nr. 638 i Vendimit Data 22.05.2019 Ora 17:00 e vendimit

Për shqyrtimin e kërkesës së tërheqjes nga kandidimi për kryetar të bashkisë Lezhë z.Salvador Kaçaj për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Kodi Zgjedhor, ndërsa parashikon kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen në paraqitjen e kandidaturës për kryetar të njësive të qeverisjes vendore, afatet dhe procedurën e regjistrimit të tyre, nuk parashikon pozitivisht (në mënyrë lejuese) dhe nuk njeh të drejtën për heqjen dorë nga kandidimi të kandidatit të regjistruar për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore dhe as të drejtën e subjektit zgjedhor (subjektit politik) për zëvendësimin e kandidatit të regjistruar të saj dhe të dorëhequr pas regjistrimit të tij rregullisht. Në vlerësim të Kolegjit Zgjedhor, mungesa e parashikimit në Kodin Zgjedhor të të drejtës së kandidatit të regjistruar për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore për të hequr dorë nga kandidimi dhe, më tej, të të drejtës së subjektit zgjedhor (subjektit politik) për zëvendësimin e kandidatit të regjistruar të saj dhe të dorëhequr pas regjistrimit të tij rregullisht, tregon se qëllimi i ligjvënësit ka qenë pikërisht mosdhënia nëpërmjet mosnjohjes pozitivisht të këtyre të drejtave për këto subjekte zgjedhore.

Sa më sipër, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve vlerëson se dorëheqja e kandidatit, z. Salvador Kaçaj, nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, gërma a, nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 3 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".

V E N D O S I

1. Mospranimin e dorëheqjes nga kandidimi si kandidat për kryetar të Bashkisë Lezhë, z.Salvador Kaçaj, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, 30 Qershor 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare



Nr. 638 i Vendimit Data 22.05.2019 Ora 17:00 e vendimit

Për shqyrtimin e kërkesës së tërheqjes nga kandidimi për kryetar të bashkisë Lezhë z. Salvador Kaçaj për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.